

Seancës Pleurore  
3/10/2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2022

**Lënda:** Propozohet për shqyrtim dhe miratim një projektligj.

**Drejtuar:** Znj. Lindita NIKOLLA  
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

**Këtu**

Znj. Kryetare e Kuvendit,

Në mbështetje të nenit 81, pikal të Kushtetutës dhe nenit 68, pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëlidhur gjeni për shqyrtim dhe miratim, projektligj "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 45, datë 28.04.2016 "Për vullnetarizmin" shoqëruar me relacionin përkatës, e propozuar nga një deputete e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Ju lutem, marrjen e masave për nisjen e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji në Kuvendin e Shqipërisë, në përputhje me nenet 68 e vijues të Rregullores.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

**DEPUTETE**

Ina ZHUPA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. \_\_/2022

**“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 45, DATË 28.04.2016  
“PËR VULLNETARIZMIN”**

Në mbështetje të nenit 81, pika 1 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e 20 mijë zgjedhësve.

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

VENDOSI:

Në ligjin nr.45, datë 28.04.2016, “Për vullnetarizmin”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Neni 25 ndryshohet si vijon:

**Neni 25**

**Regjistri Kombëtar i Vullnetarizmit**

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive krijon, mban dhe përditson Regjistrin Kombëtar të Vullnetarizmit. Ky regjistër përmban bazën e të dhënave të vullnetarizmit,

bazuar në të dhënat e dërguara nga ofruesit e vullnetarizmit, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Për të ofruar vullnetarizmin për herë të parë, ofruesi i vullnetarizmit plotëson formularin e regjistrimit dhe regjistrohet në Regjistrin e Vullnetarëve, pranë Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
3. Përmbajta formati dhe mënyra e funksionimit të Regjistrit Kombëtar të Vullnetarizmit miratohet nga ministri përgjegjës për çështjet e punësimit.

## **Neni 2**

Pas nenit 25 shtohet neni 25/1 me përmbajtje si vijon:

### **Neni 25/1**

#### **Raporti i vullnetarizmit**

1. Ofruesi i vullnetarizmit dorëzon në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, brenda datës 31 mars të cdo viti, një raport të detajuar mbi veprimtarinë e vullnetarizmit, shërbimet dhe aktivitetet, kontratat e vullnetarizimit dhe listën e vullnetarëve që kanë ofruar vullnetarizëm pranë tij gjatë vitit paraardhës.
2. Formati i raportit miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit.

## **Neni 3**

Neni 26 ndryshohet si vijon:

### **Neni 26**

#### **Libreza e Vullnetarit**

1. Çdo vullnetar pajiset me librezën e vullnetarit nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.
2. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive bën plotësimin e librezës së vullnetarit.

3. Në rastin e vullnetarit shqiptar që kryen vullnetarizëm jashtë Shqipërisë, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe aftësive bën plotësimin e librezës së vullnetarit pasi të ketë vlerësuar vërtetësinë e vërtetimeve apo certifikatave që dorëzon vullnetari.
4. Forma dhe përmbajtja e librezës së vullnetarit miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit.

#### **Neni 4**

Pas nenit 28 shtohet neni 28/1 me përmbajtje si vijon:

##### **“Neni 28/1**

##### **Sanksionet**

1. Shkelja e përcaktimeve të nenit 6, pika 1; 12; 14, pika 2; 21; 22; 25, pika 2; 25/1, pika 1, të ligjit, konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë, nga inspektorati që mbulon çështjet e punës.
2. Procedurat e shqyrtimit dhe ankimit të vendimeve për kundërvajtjet administrative, sipas pikes 1 të këtij neni, bëhen në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për inspektimin e punës.

#### **Neni 5**

Në nenin 29 bëhen ndryshimet si vijon:

1. Në pikën 2 togfjalëshi “26, pika 2” zëvendësohet me togfjalëshin “26, pika 4” dhe shtohet togfjalëshi “25, pika 3 dhe “25/1, pika 2”.

#### **Neni 6**

Në të gjithë përmbajtjen e ligjit, shprehja “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” zëvendësohet me shprehjen “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”.

#### **Neni 7**

## **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**

**LINDITA NIKOLLA**